



Pranuar / Dorezuar Prijeno/Prodato Received/Delivery	15 - 11	2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKMESHCK	5453/2021		112	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.844/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.844/2021 të datës 01.10.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr."Skënderbeu",nr.526, Komuna e Podujevës, kundër organit të punësimit/Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.844/2021 e datës 01.10.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Menaxherja e Personelit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, me datën 28.04.2021, ka nxjerrë vendimin me numër të protokollit Nr.24/2021, sipas të cilit ankuesin e ka transferuar në pozitën si "Zyrtar për logjistikë", pas propozimit të Komisionit për ristrukturim, pasi që pozita "Zyrtar për monitorim" të cilën ankuesi e ka mbajtur është shkurtuar pas hyrjes në fuqi të Rregullores nr.01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës së KRPP-së.

Ankuesi i pakënaqur me këtë transferim e po ashtu edhe me njoftimin e datës 28.04.2021, të cilin me mospajtim e ka nënshkruar, me datën 01.10.2021, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 4860/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4860/2021 të datës 01.12.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftim i datës 28.04.2021

nga Menaxherja e Personelit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik; Vendim i datës 28.04.2021 për transferimin e ankuesit; E-maili zyrtar i datës 20.09.2021; E-maili zyrtar i datës 06.05.2021; E-maili zyrtar i datës 06.05.2021; Ndryshim plotësimi i akt emërimit të ankuesit i datës 10.09.2019; Vendimi me numër të protokollit Nr.52/2019 i datës 10.09.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur, sepse:


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi me datën 01.10.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa me datën 06.10.2021, ka parashtruar kërkesë me numër të protokollit 4920/2021, me të cilën ka deklaruar se e tërheq ankesën e datës 01.10.2021. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të kësaj rrethane, konstaton se kërkesa për tërheqje të ankesës është e drejte e palës e përcaktuar me dispozitat e nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë", andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.844/2021

Ardita Perçuku-Shyti


Procesmbajtëse

Malsorë GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Bordit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

